



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:015627
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05376682

KPPP.nr.1164/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbare të kreditorit TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A., në Prishtinë, me NRB: 70280741, kundër debitorit, Ministria e Infrastrukturës, adresa Ndërtesa e Qeverisë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbare P.nr.251/22 të datës 20.12.2022, të lejuar nga Përmbaresi Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 05.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Ministria e Infrastrukturës, ashtu që Urdhri Përmbare P.nr.251/22 i datës 20.12.2022, i lejuar nga Përmbaresi Privat Isa Shala, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbaresi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit TELEKOMI I KOSOVËS Sh.A., ka lëshuar urdhrin përmbare P.nr.251/22 të datës 20.12.2022, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm faturës Nr.550022628/2081 të datës 04.03.2021, duke detyruar debitorin që brenda afatit 7 ditor nga dita e dorëzimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 244.37 Euro, me kamatëvonesë prej 8% sipas LMD-së duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbare, nën kërcënim të përmbaremit të dhunshëm.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar propozimin për përmbarim- i lejuar me urdhrin P.nr.251/22 datë 20.12.2022, i pranuar me datë 06.01.2023. Ka theksuar se kreditori nuk ka cekur nëse faturat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar ato, si dhe kur janë apo kush i ka nënshkruar faturat. Tutje ka shtuar se aprovimi blanko, pa i shqyrtuar fatura dhe pa pasur informata nëse faturat janë shqyrtuar dhe aprovuar nga debitori, i bën këto fatura jo të besueshme, dhe ka rrezik që të mund të ekzekutohen pagesa të kundërligjshme dhe kundër LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri P.nr.251/22 si dhe të hiqen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke deklaruar se asnjë nga pretendimet e debitorit nuk qëndrojnë, dhe nuk kanë bazë e as arsye të përcaktuara me dispozitën e nenit 71 të LPP-së e as të LMD-së, lidhur me nenin 69.4 të LPP-së. Tutje ka shtuar se kreditori i ka ofruar debitorit shërbimet mbi bazën e Marrëveshjes mbi Shfrytëzimin e Kontratës Publike Kornizë për Ofrimin e Shërbimeve Telekomunikuese e lidhur ndërmjet Ministrisë së Administratës Publike dhe Telekomit të Kosovës Sh.A, dhe me vet faktin se një pjesë e madhe e faturave janë paguar, hedh poshtë pretendimin e konsumatorit se një faturë nuk është dorëzuar tek debitori. Ka theksuar se përmes postës elektronike, personat përgjegjës në Ministrinë e Infrastrukturës në vazhdimësi janë njoftuar lidhur me obligimet e pashlyera (në mesin e tyre edhe obligimet për numrin e telefonit të konsumatorit D.GJ.). I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, dhe të vazhdojë me përmbarimin e urdhrin përmbarimor, P.nr.251/22, konform dispozitave ligjore të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura Nr.550022628/2081 e datës 04.03.2021, në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është dorëzuar dhe është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, ngase në këtë faturë nuk është evidentuar nënshkrimi apo vula e pranimit të debitorit, në mënyrë që debitori të njoftohet me detyrimin që buron nga e njëjta.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimi i faturës konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbarimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1164/23 me datë 05.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.